

FORMULAR I VETËVLERËSIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR

Për periudhën e vlerësimit 202.... – 202...

Të dhënat personale të përmbaruesit gjyqësor

Emri:

Mbiemri:

Datëlindja:

Vendbanimi:

Zyra Përmbarimore:

Data e emërimit në pozicionin aktual:

Adresa e e-mailit zyrtar:

Numër telefoni:

Formulari i vetëvlerësimit (më poshtë: formulari) dhe hapat për plotësimin e tij.

1. Ky formular vetëvlerësimi, plotësohet nga përmbaruesi gjyqësor në në në Kreun IX mbi “Vlerësimin Etik dhe Profesional të Përmbaruesit Gjyqësor Shtetëror”, të Ligjit 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror si dhe Urdhërit nr.167 datë 25.03.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizmin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit”.
2. Ky formular është pjesë e akteve të vlerësimit dhe përbën burim vlerësimi në kuptim të dispozitave të ligjit 8/2023 si dhe dispozitave të Urdhërit nr.167 datë 25.03.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit”.
3. Formularit i bashkëngjiten dokumentacioni përkatës i cili sipas vlerësimit të përmbaruesit gjyqësor konfirmon vlerësimin e këtij të fundit në lidhje me kriteret e vendosura si dhe dokumente që tregojnë angazhimin në veprimtaritë profesionale ndërinstitucionale gjatë periudhës së vlerësimit, trajnimet (përmbajtja, kohëzgjatja, të dhëna mbi institucionin organizues) dhe çdo dokument tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të

4. Përmbaruesi gjyqësor plotëson formularin në rubrikat përkatëse të caktuara për të dhe ia dorëzon Kryetarit të Zyrës Përmbarimore, brenda 3 javëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Këshillit të Përmbarimit për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional.
5. Formulari plotësohet dhe nënshkruhet nga përmbaruesi gjyqësor.
6. Përmbaruesi gjyqësor vetëvlerësohet sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në Ligjin Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, duke përzgjedhur vetëm njërën nga shkallët e aftësisë për çdo tregues vlerësimi.
7. Përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të japë shpjegime dhe të argumentojë vetëvlerësimin e tij, duke parashtruar të dhënat, kushtet e punës dhe arsyet që sipas tij/saj justifikojnë një shkallë më të lartë aftësie se ajo që rezulton nga të dhënat statistikore.

VETËVLERËSIMI KUNDREJT KRITEREVE VLERËSUESE

1.Vlerësimi i aftësive profesionale të përmbaruesit gjyqësor shtetëror

Me anë të kriterit të aftësisë profesionale të përmbaruesit gjyqësor shtetëror vlerësohet aftësia profesionale e tij në drejtim të njohurive profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbarimor, njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, shitjes së sendeve në ankand publik, si dhe konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e titullit ekzekutiv, procedurat që duhen ndjekur, saktësia dhe qartësia në hartimin e akteve procedurale, respektimi i afateve ligjore etj.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për të kryer veprimet procedurale konform objektit të titullit ekzekutiv që është regjistruar për ekzekutim, duke identifikuar natyrën e tij dhe procedurat që duhet të ndiqen në funksion të ekzekutimit të tij apo dhënies së zgjidhjes ligjore. Kryhet një vlerësim i të gjithë komponentëve që duhet të ketë një shkresë që të konsiderohet veprim i duhur përmbarimor.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbartuesi gjyqësor shtetëror duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe mund të bashkëngjisi dokumentacion për titujt ekzekutiv që sipas vlerësimit të tij kanë pasur vështirësi apo që janë ekzekutuar apo kanë marrë zgjidhje ligjore sipas afateve të përcaktuara.)

1.A-b Aftësia për të zbatuar vendimet gjyqësore duke mos tejkaluar atë çka ka vendosur vendimi gjyqësor si detyrim për palën/palët debitore qoftë subjekt fizik apo juridik, institucione shtetërore. Në këtë kriter vlerësohet aftësia e përmbartuesit gjyqësor për kryerjen e veprimeve procedurale bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, akteve nenligjore jurisprudencës shqiptare dhe të huaj që në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, Konventave Ndërkombëtare.

Si e vlerëson përmbartuesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbartuesi gjyqësor shtetëror duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjorë të përzgjedhura prej tij)

1.B Arsyetimi ligjor.

1.B-a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e dokumentit ligjor

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbartuesit gjyqësor shtetëror për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, aftësia për të shprehur në mënyrë korrekte detyrimin ligjor që përmban titulli ekzekutiv, përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç), organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave procedural.

Si e vlerëson përmbartuesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbartuesi gjyqësor shtetëror duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjorë të përzgjedhura prej tij.)

1.B-b Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbartuesit gjyqësor për të identifikuar si dhe për të analizuar shkaqet ligjore që bëhen pengesë në ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Aftësia profesionale për tu drejtuar në instancat e duhura që lidhen direkt dhe indirekt me ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Dhënia e zgjidhjes ligjore mbi çështjet në ngarkim të tij/saj.

Si e vlerëson përmbartuesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbartuesi gjyqësor shtetëror duhet të japë shpjegime referuar veprimtarisë së tij profesionale gjatë periudhës së vlerësimit dhe dokumenteve ligjorë të përzgjedhura prej tij)

2.Vlerësimi i aftësive organizative të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

Me anë të kriterit të aftësive organizative vlerësohet aftësia e përmbaruesit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat përmbarimore, si dhe aftësia për të administruar dosjet përmbarimore duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga përmbaruesi dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit. Ky komponent matet duke u bazuar në shpejtësi, rendiment, respektimin e afateve ligjore.

2 A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A-a Treguesi sasior në përfundimin e dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për të përballuar ngarkesën në punë, për çdo kategori çështjesh, e cila matet ndërmjet krahasimit të dhënave nga viti në vit për periudhën e vllërësimit

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

I pamjaftueshëm ☐ Mjaftueshëm ☐ Mirë ☐ Shumë mirë ☐ Shkëlqyeshëm ☐

Shpjegime : (Këtu përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve, volumin e tyre, rritjen e numrit të dosjeve të ngarkuara për ekzekutim këtij të fundit)

2.A-b Rendimenti i përmbaruesit gjyqësor në çështjet përmbarimore në ngarkim të tij.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për ekzekutimin e çështjeve përmbarimore në ngarkim të tij, për dhënien e zgjidhjes ligjore. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror bën një pasqyrë të gjithë veprimtarisë së tij të kryer gjatë periudhës së vlerësimit, çështje të ekzekutuara, të pezulluara, pushuara etj krahasuar me numrin e çështjeve që ka në ngarkim.

Përmbaruesi gjyqësor shtetëror bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm ☐
Shpjegime : (Këtë përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të japë shpjegime mbi situatën faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve në ngarkim të tij, procedurat e ndjekura, volumin e tyre, numrin e ëshetjeve në ngarkim, shkaqet ligjore të mosekzekutimit)				

2 B.Aftësia për të përfunduar në kohë çështjet e ngarkuara.

2.B-a Respektimi i afateve procedurale gjatë kryerjes së veprimeve procedurale.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbauesit gjyqësor për të kryer veprimet procedurale në afatet e parashikuara në dispozitat ligjore për çdo çështje që ka në ngarkim, krahasuar me numrin e çështjeve që ka në ngarkim.

Përmbauesi gjyqësor bën një analizë të pavarur të të dhënave të tij statistikore dhe përzgjedh shkallën e aftësisë së tij.

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbauesi gjyqësor shtetërori mund të japë shpjegime mbi mund të dokumentoj apo të jap informacion për çështjet gjyqësore që i ka ekzekutuar apo dhënë zgjidhje ligjore në një nga format e parashikuara nga ligji procedural dhe sipas afateve të përcaktuara)

2 C. Metodologjia e punës (Aftësia për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës)

2.C-a Aftësia për të evidentuar e kryer veprimet e nevojshme dhe shmangien e veprimeve joproduktive në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor për kryerjen më prioritet të veprimeve procedurale në tituj ekzekutiv me natyrë sensitive dhe që kanë nevojë për kryerjen e veprimeve procedurale në mënyrë të menjëhershme si psh: takimet me fëmijë, marrje fëmije,

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij ?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime : (Këtu përmbaruesi gjyqësor shtetëror mund të japi të dhëna statsitkore mbi titujt ekzekutiv të tillë që ka pasur në ekzekutim, të shpjegoj procedurat dhe afatet kohore që i janë dashur për ekzekutimin apo dhënien e zgjidhjes ligjore sipas formave të parashikuara në dispozitat ligjore.)

2.C-b Rregullshmëria, saktësia në organizimin dhe mbajtjen e dosjes përmbarimore.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor për mirëorganizmin dhe administrimin e akteve përmbarimore në dosjen përmbarimore, inventarizimi i shkresave, vendosja e tyre në një rend kronologjik dhe të kuptueshëm.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror shkallën e aftësisë së tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime:

--

3.Vlerësimi i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

Pikëzimi i këtij treguesi vlerësimi bëhet mbi bazën e parimit kushtetues që çdo përmbarues gjyqësor shtetëror për shkak të statusit të tij ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Procesi i vlerësimit për këtë kriter bazohet në parimin e prezumimit të pasjes së vlerave të tilla themelore në lidhje me ushtrimin e detyrës.

3.A Etika në punë.

3.A-a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor për të shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetën më shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror shkallën e tij të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion?

I pamjftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
---	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime :

--

3.B Integriteti.

3.B-a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Me këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese si dhe çdo tendencë për paragjykim.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror aftësinë e tij për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime :

3.B-b Numri i ankesave të shqyrtuara, kërkesave për heqje dorë, rekomadimet dhe masat e marra nga grupet e kontrollit.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për të shfaqur paanësi në funksion, referuar raportit të numrit të çështjeve të ngarkuara gjatë periudhës së vlerësimit, numrit të kërkesave të bëra prej tij për heqje dorë, ankesave të paraqitura, masat apo rekomandimet e lëna për të nga grupet e kontrollit.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor veprimtarinë e tij?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime :

4.Vlerësimi i aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Me anë të këtij kriteri vlerësohen aftësitë e komunikimit, aftësia për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmëria për punë në grup, si dhe aftësia për t'u angazhuar në trajnime profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A-a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor për të qenë transparent në komunikim dhe për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe koncize me qytetarët, kolegët, me përfaqësuesit e institucioneve apo subjekteve që paraiten pranë zyrave përmbarimore

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetror aftësinë e tij për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime :

4.A-b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për të treguar kujdes për ruajtjen e konfidencialiteti dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionit dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Si e vlerëson përmbaruesi gjyqësor shtetëror aftësinë e tij në lidhje me respektimin e konfidencialitetit dhe të dhënave personale?

I pamjaftueshëm ☐	Mjaftueshëm ☐	Mirë ☐	Shumë mirë ☐	Shkëlqyeshëm ☐
--	--------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------------	---------------------------------------

Shpjegime :

4.B Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.B-a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues dhe në trajnimet e detyrueshme për përmbaruesin gjyqësor sipas përcaktimeve të Ligjit 8/2023.

Në këtë tregues vlerësohet angazhimi i ndihmësmagjistratit në programin e trajnimit vazhdues dhe trajnimin detyrues me qëllim ngritjen e tij profesionale.

A e ka përmbushur përmbaruesi gjyqësor shtetëror detyrimin ligjor mbi pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues dhe detyrues gjatë periudhës së vlerësimit ?

Po ☐

Jo ☐

Shpjegime : (Këtu përmbaruesi gjyqësor shtetëror duhet të përcaktojë pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë periudhës së vlerësimit. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit)

4.B-b Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit përmbarimor.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e përmbaruesit gjyqësor për t'u angazhuar në veprimtari për të përmirësuar sistemin përmbarimor me ose pa pagesë, të tilla si : prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrje në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Shpjegime : (Përmbaruesi gjyqësor shtetëror duhet të listojë këtu informacione mbi pjesëmarrjen dhe/ose përfshirjen në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të përmbarimor si dhe kontributin e tij në këto veprimtari).

4.B-c Publikime ligjore akademike.

Në këtë tregues vlerësohet aftësia dhe gatishmëria e përmbaruesit gjyqësor shtetëror për të publikuar shkrime, artikuj ligjorë me natyrë akademike ose praktike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës apo njohjen e praktikantëve të së drejtës me zhvillimet më të fundit të jurisprudencës vendase dhe të huaj.

Shpjegime : (Përmbaruesi gjyqësor shtetëror duhet të listojë këtu informacione mbi botimet e tij si p.sh të dhënat për sasinë, tipologjinë dhe impaktin e publikimeve ligjore akademike. Dokumentacionin përkatës ia bashkëlidh formularit.)

Në referim të nenit 62, të “Ligjit Për Organizmin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, përmbaruesi gjyqësor shtetëror jep mendim për sa më poshtë:

a. Detyrat e ushtruara përkundrejt kriterëve vlerësuese.

Shpjegime :

b. Analizë të të dhënave statistikore që lidhen veprimtarinë e tij si përmbarues

Shpjegime :

c. Masat që ka ndërmarrë për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vlerësimin e mëparshëm.

Shpjegime :

d. Përshkruan shkallën në të cilën janë përmbushur objektivat duke dhënë shpjegimet përkatëse

Shpjegime :

e. Objektivat për zhvillimin e tij profesional në të ardhmen

Shpjegime :

f. Nevojat për trajnim profesional dhe pengesat për zhvillimin profesional.

Shpjegime :

Për t'u plotësuar nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror:

Plotësuar nga :

Emër:

Mbiemër:

Nënshkrimi:

Dorëzuar në datë :

Marrë në dorëzim nga Kryetari : Emër: Mbiemër: Nënshkrimi

